



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVES
KUVENDI E REPUBLIKES SE KOSOVES
SKUPSTINA REPUBLIC OF KOSOVO
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Cena për Propozime dhe Mërzitje - Koncatorja za Predloga i Predavanja Ustav
Nr. Prot. 06/1384 / D₀-778
Bi Prot.
Prot. No:
Nr. i faqeve
Broj stranica
No. pages:
Data
Datum
Date 24.05.2018
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Punëve të Jashtme z. Begjet Pacolli</i>	DATE DATUM DATE	24.05.2018
NGA / OD / FROM	<i>Deputetja Blerta Deliu Kodra</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Fushata agresive e Serbisë për tërheqjen e njohjeve ndaj shtetit të Kosovës, si dhe veprimet e fundit të Serbisë përfshirë edhe ndalimin e sportistëve kosovar që të marrin pjesë në gara, ka për qëllim pengimin e Kosovës në përfaqësimin e saj në arenën ndërkombëtare dhe bie ndesh në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ndërkohë që shteti serb ka filluar një fushatë lobuese për tërheqjen e njohjeve të Republikës së Kosovës nga shtetet të cilat tashmë e kanë njohur Republikën e Kosovës.

PYETJE :


I nderuari Ministër:

Ministria e Punëve të Jashtme a ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret për të i'u kundër përgjigjur kësaj fushate agresive të shtetit serb në raport me Republikën e Kosovës?



REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Data për Përdorim të Parashirëso Kartelave dhe Produktet e Përdorur të Tërësishëm	
No. i Kartelave Prod. No.	06/1387 / D-781
No. i Kartelave Prod. No.	24.05.2018
DOKUMENTI I PARASHIRËSË	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Shëndetësisë – Uran Ismaili</i>	DATE DATU M DATE	24 Maj 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Naser Rugova, Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së</i>		
SUBJE KTI PREDM ET SUBJE CT	<i>Pyetje Parlamentare</i>		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Mbikëqyrja dhe menaxhimi i mbeturinave nga produktet medicinale të gjeneruara nga institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Pyetja:

Si është gjendja me identifikimin, klasifikimin dhe monitorimin e mbeturinave që gjenerohen nga institucionet shëndetësorë publike dhe private në Republikën e Kosovës?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Përdorime - Koncili i Përditshëm - Propozime të Dërguara
No. i Propozimit / No. i Propozicije / No. i Propozitione
06/1398/0780
Data / Datum / Date
28.05.2018
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

PËR/ZA/TO	Pal Lekaj, Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës	DATE DATUM DATE	28/05/2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Hykmete Bajrami, Deputete e Grupit parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Në seancën e 17.05.2018, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kam ngritë çështjen e UA 02/2018 për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore, UA ky i MI, të cilin ju e keni nënshkruar me 12.04.2018 dhe ka hyrë në fuqi shtatë ditë me vonë d.m.th. me 19.04.2018. Nene të caktuara të këtij UA kanë përshtatë kushtet që monopoli në këtë fushë të vazhdoj në pafundësi. Meqenëse UA 02/2018 është në kundërshtim edhe me Nenin 199 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në kundërshtim me Ligji nr.05/L-132, nga i cili derivon, Grupi Parlamentar i LDK-së ka kërkuar që menjëherë ky UA të shfuqizohet dhe të hartohet një i ri, i cili përcakton kushte të barabarta për të gjithë operatorët që janë të interesuar të angazhohen në këtë fushë.

PYETJE PARLAMENTARE: A keni marrë masa deri me tani rreth kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së për shfuqizimin e këtij UA? Nëse jo. A planifikoni ta shfuqizoni këtë UA dhe kur?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKË E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi - Skupština - Assembly
06/1399/10-787
Date
Datum
Data 28.05.2018
PRISTINA - PRISTINA

FËR/ZA/TO	Shyqiri Bytyqi, Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	DATE DATUM DATE	28/05/2017
		Reference	
NGA/OD/FROM	Hykmete Bajrami, Deputete e Grupit parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Gjatë dy leximeve të Ligjit të Buxhetit për vitin 2018, si deputete kam paraqitë amendament për ndarjen e mjeteve, për ndërtimin e shkollës në fshatin Sferkë, komuna e Pejës, shkollë kjo, paralele e shkollës së Kliqinës "Naum Veqilharxhi". Me mbështetjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Ministrit të Financave, mjetet janë ndarë sipas një parallogarie që e ka bërë Komuna e Pejës në shumën prej 127,178 Euro . Këto mjete janë ndarë të buxheti i MASHT-it, për vitin 2018, konkretisht të investimet kapitale, në arsimin para universitar. Projekti me kod 1571. Qëllimi i projektit ka qenë dhe është që në shtator të vitit 2018 fëmijët të zhvillojnë mësimin në shkollën e re, pasi që ajo aktuale paraqet rrezik permanent për nxënësit.

PYETJE PARLAMENTARE: A keni filluar procedurat për ndërtimin e shkollës, pasi që shkolla është projekt një vjeçar dhe sa ka gjasa që shkolla të jetë gati për shtator?



REPUBLICA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA E KOSOVES
PRISTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Kancelaria e Kancelarit të Propozimeve dhe Kancelarit të Propozimeve
06/1423/06-803
Data
Datum
Date 01.06.2018
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR/ZA/TO	Z. Uran Ismaili Ministër i Shëndetësisë	DATE DATUM DATE	01.06.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	Besa Baftiu Deputete e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Ndërtimi i Spitalit Pediatrik në hapësirën e QKUK-së

Pyetja Parlamentare:

Ndërtimi i Spitalit Pediatrik në hapësirën e QKUK-së që do të integrojë shërbimet shëndetësore që kanë të bëjnë me fëmijët sipas planit do të duhej të përfundonte në fund të këtij viti. Ky projekt ka vlerë prej 22 milion euro dhe është donacion nga Emiratet e Bashkuara Arabe.

Z. ministër pse ende nuk ka filluar së ndërtuari ky spital, ku qëndron problemi kur dihet se Minsitria e Shëndetësisë është deklaruar se do të jap mbështetjen në të gjitha fazat me qëllim që projekti të përfundojë me kohë.